**URDHËR**
**Nr. 156, datë 30.7.2026**

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 424, DATË 24.7.2015, TË MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN NË NDËRTIMET E DESTINUARA PËR BANIM"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", të ndryshuar dhe në kuadër të rishikimit të akteve nënligjore, meqenëse rregullat për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në ndërtimet e destinuara për banim të miratuara me urdhrin nr. 424, datë 24.7.2015, janë përfshirë dhe miratuar me vendimin nr. 626, datë 15.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e normativave të projektimit të banesave", si dhe duke marrë në konsideratë se ligji nr. 8766, datë 5.4.2001, "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin", është shfuqizuar nga ligji nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 424, datë 24.7.2015, të ministrit të Punëve të Brendshme, "Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në ndërtimet e destinuara për banim", me qëllim shmangien e mbivendosjes së akteve nënligjore dhe garantimin e qartësisë, koherencës dhe sigurisë juridike të legjislacionit në fuqi.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, drejtoritë dhe sektorët e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel vendor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
**Besfort Lamallari**